



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 146/6 prot.

Tiranë, më 26. 07. 2023

V E N D I M

Nr. 138, datë 26. 07. 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 17 Regj., datë 24.01.2023, që i përket ankuesit K. H., kundër Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkisë Durrës, me pretendimin diskriminimin për shkak të gjendjes ekonomike dhe vendbanimit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në këtë kuadër, K. H. ka parashtruar ndër të tjera në ankesë se: “*...Jam banor dhe një nga përfaqësuesit e banorëve të pallatit 1047, i cili prej tërmetit të 26 Nëntorit 2019 ka pësuar dëme në strukturën mbajtëse. Dua të theksoj që pallati ka 32 familje, një komunitet prej të paktën 100 persona banues në godinën e dëmtuar. Godina ndodhet 50 metra larg nga bregu i detit dhe është nën ndikimin e kushteve atmosferike, kripës së detit dhe erërave që janë karakteristike për zonat bregdetare, të cilat gërryejnë përditë strukturën. Pra kemi të bëjmë me lënien e godinës në mëshirë të fatit dhe në një degradim të përditshëm.*

Kemi më shumë se 3 vite që i bëjmë kërkesa të vazhdueshme institucioneve të pushtetit vendor dhe qëndror për të rforcuar pallatin dhe për të siguruar banimin në të, pasi godina është me nivel dëmi DS4 i përcaktuar në “Aktin e Ekspertizës mbi Performancën Strukturore të Ndërtesës nr. 16 (1047) në Rrugën e Epikadeve , Durrës”, të kryer nga A. B. dhe I. P., ekspertë pranë Institutit të Ndërtimit. Tek Akti i Ekspertizës theksohet se: “Godina që pësoj dëme nga tërmeti i 26 Nëntorit duhet të rforcohet”.

Ritheksojmë që godina ka nevoja të menjëhershme për riforcim sepse banorët nuk janë larguar, kanë vijuar rregullisht jetesën në të dhe pushteti vendor dhe qëndror nuk kanë gjetur një zgjidhje për situatën. Të ndodhur para këtij fakti ne jemi nën trysninë e erozionit atmosferik, lëkundjeve sizmike dhe degradimit të përditshëm të strukturës. Ne i kemi bërë kërkesa të vazhdueshme pushtetit vendor dhe qëndror për urgjencën e fillimit të punimeve rifuqesuese, por deri më tani nuk është përcaktuar asnjë afat kohor për lëvrimin e fondit dhe fillimin e procedurës për nisjen e punimeve.

Bashkia e Durrësit ka bërë kërkesë për financimin e riforcimit të pallatit e cila pasqyrohet në kthimin e përgjigjes me Nr. 7468/2 prot., të datës 20.09.2022, ku Kryetarja e Bashkisë së Durrësit dhe stafi përgjegjës na kanë theksuar se është çështje financimi dhe janë në pritje të lëvrimin të fondit nga ana e pushtetit qëndror.

Në kushtet që ndodhemi nuk kemi një afat se kur mund të lëvrohet fondi, afati kohor mund të jetë nesër ose në përjetësi.

Pothuajse të gjithë godinat në qytetin e Durrësit me nivel dëmi DS4 kanë filluar dhe një pjesë e madhe prej tyre janë drejt përfundimit.

Ne banorët e pallatit 1047 nuk arrijmë të kuptojmë: Kush janë kushtet që duhet të përmbushë një pallatë që të fillojnë punimet? Si bëhet përzgjedhja e pallateve për tu rifuqesuar? Si përcaktohen godinat që do të përfitojnë fondet e rifuqesimit?

Në këtë gjendje ndihemi të diskriminuar përballë përzgjedhjeve që kanë kryer institucionet e pushtetit vendor: Pse duhet të lihet në hije një pallat me të paktën 100 banorë, të cilët jetojnë aty? Në këto vite na kanë thënë që të presim, por ne si banorë jemi të alarmuar sepse pritja mund të jetë në pafundësi dhe pallati degradohet përditë e më shumë”.

Në vijim të shqyrtimit të çështjes, ankuesi me anë të e-mail-it datë 01.02.2023, ka plotësuar ankesën me informacion shtesë, ku ndër të tjera ka sqaruar se: “...Ne po na mohohet siguria e jetës në këtë godinë sepse jemi vazhdimisht të rrezikuar nga shkaqet natyrore dhe pallati mund të rrëzohet mbi kokat tona. Ne si komunitet nuk kemi mundësi ekonomike të bëjmë ndërhyrje rifuqesuese, prandaj i jemi drejtuar institucioneve që ta vlerësojnë, sipas vëzhgimeve shkencore ka dal dhe kostoja për rifuqesimin e godinës...”.

Në përfundim, K. H. ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për lëvrimin sa më parë të fondit nga pushteti qëndror dhe institucionet përgjegjëse, si dhe fillimin e procedurave të menjëhershme të rifuqesimit të pallatit nga ana e Bashkisë Durrës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin

gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së, i ndryshuar, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010, i ndryshuar, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 146/1 prot., datë 10.02.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, neni 32, pika 2, ka kërkuar nga ana e Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkisë Durrës, që të jepen parashtrime lidhur me të gjitha pretendimet e ngritura, nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Bashkia Durrës, me shkresën¹ Nr. 1723/1 prot., datë 17.02.2023, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “Përsa i përket objektit pallat nr. 1047 (Arvi), kod gis 27498, me nivel dëmi DS4, ju bëjmë me dije se projekti dhe preventivi i këtij objekti është hartuar nga studio projektuese “Arkonstudio” në bazë të kontratës, Nr.661 Prot., datë 18.01.2021, të lidhur me Bashkinë Durrës, me objekt hartimin e projekteve të riforcimit, sipas rekomandimeve të lëna nga akt ekspertizat e hartuara nga Instituti i Ndërtimit.

Në vijim të materialit të hartuar nga studio projektuese, sëbashku me opionencën teknike të hartuar nga Instituti i Ndërtimit për këtë projekt, nga ana jonë është kërkuar fond pranë Ministrisë përkatëse për financimin e punimeve të riforcimit strukturor të këtij objekti (shkresa Nr.2319 Prot., datë 10.3.2022).

¹ Protokolluar pranë Komisionerit me shkresën Nr. 146/2 prot., datë 20.02.2023

Gjithashtu, me shkresën protokolluar me tonën Nr. 9462 Prot., datë 24.11.2022, kemi dërguar pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë “Informacion mbi objektet e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 të pafinancuara”, përmes së cilës kemi informuar se objekti me kod GIS 27498 është ende i pa financuar.

Referuar procedurës, fillimisht miratimi i fondeve të kërkuara bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave, më tej ky fond miratohet me Vendim të Këshillit Bashkiak Durrës, për të vijuar me procedurën e prokurimit publik për përzgjedhjen e subjektit që do të kryejë punimet e riforcimit.

Në territorin e Bashkisë Durrës aktualisht kemi dhe 5 pallate të tjera për të cilat kemi kërkuar financimin e punimeve të riforcimit të godinave pallat, dhe nuk është miratuar fondi. Këto pallate ndodhen në njësinë administrative nr.1, 3 dhe 5, dhe nuk ndodhen në afërsi të pallatit nr. 1047, ku banon ankuesi.

Gjithashtu nga ana jonë pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është dërguar informacion se ka mbetur pa financuar dhe fondi i kërkuar për hartimin e projekteve për riforcimin e objekteve sipas rekomandimeve të aktekspertizave të thelluara të realizuara nga Instituti i Ndërtimit Tiranë.

Ju sqarojmë se fillimisht të gjitha kërkesat për fond nga ana e Bashkisë Durrës depozitohen pranë Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, më tej me ndryshimet përkatëse këto kërkesa i janë adresuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.”

2. Me shkresën nr. 147/4 prot., datë 27.03.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, neni 32, pika 2, ka kërkuar nga ana e Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, që të jepen parashtrime lidhur me të gjitha pretendimet e ngritura, nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën² Nr. 3091/1 prot., datë 06.04.2023, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...K. H. ka përcjell zyrtarisht pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe nëpërmjet Platëformës së Bashkëqeverisjes, shqetësimin se vonesat në lëvrimin e fondeve, kanë penguar Bashkinë Durrës për zhvillimin e procedurave për riforcimin e ndërtesës me njësi banimi (pallat), me kod GIS 27498, ku ai banon.

Nga ana e saj Bashkia Durrës me shkresën nr. 9462 prot., datë 24.11.2022 ka bërë me dije cilat janë objektet e dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 ende të pafinancuara.

Gjatë kësaj kohe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka punuar për planifikimin e shpërndarjes së fondit të rindërtimit, të miratuar me ligjin nr. 84, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023”.

Referuar sa u përmend më sipër, kërkesa për financimin e Bashkisë Durrës, nëpërmjet së cilës trajtohet edhe shqetësimi i ngritur nga K. H., është trajtuar në Vendimin e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr. 109, datë 23.03.2023, pika 1, e cila ndryshon pikën 20 të Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit nr. 101, datë 13.04.2022.

² Protokolluar pranë Komisionerit me shkresën Nr. 146/2 prot., datë 20.02.2023

Gjithashtu, është hartuar edhe Projekt Vendimi i Këshillit të Ministrave për lëvrimin e fondit Bashkisë Durrës dhe caktimin e Bashkisë Durrës si njësi zbatuese, i cili është përcjellë për mendim pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Drejtësisë.”

3. Në këto kushte, për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës nr. 146/5 prot., datë 13.04.2023 “Njoftim për seancë dëgjimore”, Komisioneri njoftoi palët lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 24.04.2023.

Seanca dëgjimore u zhvillua me praninë e palëve në proces: ankuesit K. H. dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, Bashkia Durrës dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Ndërsa, nga ana e Këshillit të Ministrave nuk u paraqit asnjë përfaqësues.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, subjektet i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në, të cilat do të shtjellohen në vijim.

Në vijim të seancës dëgjimore ankuesi shtoi faktin se nga ana e Bashkisë Durrës nuk është trajtuar me bonus qiraje, si dhe në rrugë informale është bërë me dije nga ana e njësisë administrative ku ai bën pjesë, se nuk mund ta përfitojë atë, pasi këta të fundit nuk janë të informuar që pallati në të cilin ai jeton ka dëmtime të nivelit DS4. Sipas tij, nga ana e Bashkisë Durrës, pas ekspertimit fillestar të bërë nga Instituti i Ndërtimit ku konstatoi nivelin e dëmtimit DS2, ai dhe banorët e tjerë të pallatit kanë përfituar një shumë prej 250.000 lekë për riparimin e dëmeve të brendshme të banesave. Pas kundërshtimit të akt-ekspertimit nga banorët, Instituti i Ndërtimit riekspertoji pallatin ku ai banon dhe doli në përfundimin që niveli i dëmtimit të tij është DS4. Në këtë kuptim, pallati kishte nivel dëmi të lartë dhe në të nuk mund të banohej pa ndërhyrë në rifuqimin e tij. Pavarësisht këtij fakti, ankuesi theksoi se nuk kishte pranuar të linte shtëpinë, pasi masa e bonusit të qirasë ishte e ulët dhe me atë vlerë, ai do të zhvendosej në një lagje më të largët, gjë e cila do t'i sillte dëm ekonomik pasi jeta dhe puna e tij ishte e lidhur me atë lagje. Në përfundim, ankuesi sqaroi se vetëm nëse nga ana e institucioneve përgjegjëse do të miratohej fondi i rifuqimit, ai do të ishte dakord të largohej nga banesa e tij, deri në përfundim të punimeve të pallatit.

Nga ana e përfaqësueses së Bashkisë Durrës ndër të tjera u theksua se, sa i përket punimeve në pallatet/banesat me nivel dëmi DS1-DS3, të cilat nuk janë dëmtime strukturore, ato kanë përfunduar. Ndërsa, pallatet me nivel dëmi DS4 dhe DS5, të cilat kanë dëmtime strukturore, nuk kanë përfunduar punimet. Për rastin konkret, fillimisht pallati në të cilin banon ankuesi, është vlerësuar me nivel dëmi DS2 dhe sipas akteve nënligjore në fuqi, banorët kanë përfituar një vlerë prej 250.000 lekësh për riparimet e brendshme të banesave. Pas kundërshtimit të vlerësimit, u krye

sërisht ekspertimi i dëmit dhe pallati u konstatua në nivel dëmi DS4. Pas këtij momenti, Bashkia Durrës nisi procedurat e prokurimit për përzgjedhjen e një shoqërie private e cila do të përcaktonte vlerën e dëmit të shkaktuar. Pasi shoqëria e kontraktuar hartoi projekt preventivin dhe mori opionencën nga ana e Institutit të Ndërtimit, Bashkia Durrës në vitin 2022, iu drejtua Ministrisë përgjegjëse për financimin e punimeve për rihforcimin e pallatit të ankuesit dhe 7 pallateve të tjera në qytetin e Durrësit. Nga ai moment Këshilli i Ministrave nuk ka dal me vendim për miratimin e fondit për rihforcimin e këtyre objekteve. Në këto kushte, Bashkia Durrës theksoi se nuk mund të ndërhyjë për realizimin e punimeve të rihforcimin e pallatit ku banon ankuesi, pasi ende nuk është miratuar nga Këshilli i Ministrave fondi i kërkuar. Në përfundim, Bashkia Durrës parashtroi se në afërsi të godinës së saj por edhe jo shumë larg nga pallati ku banon ankuesi, është një tjetër objekt (pallat), me nivel dëmi DS4, i cili ndodhet në të njëjtën situatë. Bashkia Durrës shtoi se, punimet për rihforcimin e pallateve me nivel dëmi DS4, për një pjesë kanë përfunduar, një pjesë janë në proces, ndërsa objekti ku banon ankuesi dhe për 7 (shtatë) pallate të tjerë, pritet miratimi i fondit nga Këshilli i Ministrave.

Sa i përket faktit që banorët e pallatit vijnë të jetojnë aty edhe pse ai është i pabanueshëm dhe përbën rrezik për jetën e tyre, Bashkia Durrës theksoi se nuk ka informacion mbi arsyet përse nuk janë larguar prej aty, por vuri theksin në faktin që u ofrohet bonusi i qirasë deri në momentin e përfundimit të punimeve, duke plotësuar dokumentacionin përkatës pranë njësive administrative.

Në përfundim, nga ana e përfaqësueses së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë u theksua se është hartuar projekt vendimi i Këshillit të Ministrave për financimin e punimeve të objekteve me nivel dëmi DS4 në Bashkinë e Durrësit dhe i është dërguar për mendim Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë.

Në mbyllje të seancës, nga ana e strukturave të Komisionerit, iu kërkua Bashkisë Durrës të vendos në dispozicion të shqyrtimit të çështjes, informacion lidhur me masat e marra për moslejimin e banorëve për të jetuar në pallatin objekt ankese, pasi mund ti rrezikohej jeta, por nga ana e tyre nuk u vu në dispozicion asnjë informacion edhe pas seancës dëgjimore.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankueses, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë*

të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në *“shkakun e mbrojtur”*.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Në nenin 5, pika 1, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar përcaktohet se: *“1. Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedurë, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë”.*

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a dhe b³, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo

³ Neni 20/1/a dhe b, të ligjit nr. 10221/2010: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t'i arrijë ose t'i përdorë ato: a) duke refuzuar t'i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi...”*

shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;

- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ai i është nënshtruar ndonjë trajtimi të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për të përfituar të mira apo shërbime dhe më konkretisht në lidhje me vonesat në lëvrimin e fondit nga institucionet përgjegjëse dhe fillimin e procedurave të menjëhershme të rifuqimit të pallatit ku ai banon.

Nga këqyrja e dokumentacionit dhe kronologjia e ngjarjeve dhe fakteve rezulton se:

Për shkak të fatkeqësisë natyrore, si shkak i tërmetit që preku Shqipërinë në datë 26 Nëntor 2019, Këshilli i Ministrave miratoi Aktin Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 “Për Përballimin e Pasojave të Fatkeqësisë Natyrore”, i cili në Nenin 5 ka përcaktuar subjektet përfituese. Kështu në pikën 1 të nenit 5 përcaktohet se: *“Subjekte përfituese janë individët dhe familjet, që kanë humbur një ose më shumë anëtarë të familjes dhe/ose kanë pësuar dëme në banesat e tyre dhe kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe institucionet publike që kanë pësuar dëme në ndërtesat apo infrastrukturën publike në pronësi apo në administrim të tyre, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore”*.

Në nenin 18, pika 7 të VKM-së së sipërcituar është parashikuar se: *“7. Kushtet, kriteret, kategoritë prioritare, procedurat dhe rregullat për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, përfshirë dhe autoritetet përgjegjëse shtetërore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Përfituesit nuk mund të përfitojnë në të njëjtën kohë nga më shumë se një program i procesit të rindërtimit për qëllime strehimi, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë akt. Autoritetet përgjegjëse marrin masa që subjektet të cilat nuk përfitojnë nga një program i caktuar, të kenë mundësi për të kaluar në një program tjetër të procesit të rindërtimit, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave. Subjektet përfituese nga programet e procesit të rindërtimit konsiderohen që shpërblehen, jo më shumë se vlera e dëmit real të përbërë nga humbja e pësuar e jetës së njeriut dhe/ose vlera e dëmeve pasurore”*.

Në Aktin Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, janë përcaktuar në mënyrë të qartë rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve qendrore dhe lokale për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyror. Sakaq:

- Referuar nenit 13, Këshilli i Ministrave miraton:
 - a) politikat për përballimin dhe rregullimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore dhe fatkeqësive të tjera.
 - b) propozimet e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit për:

- i. përdorimin e fondit të rindërtimit nga njësitë zbatuese dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, për qëllimet dhe sipas parashikimeve të përcaktuara në këtë akt normativ;
 - ii. programin e përgjithshëm të rindërtimit;
 - iii. përcaktimin e njësive zbatuese për projektet në kuadër të procesit të rindërtimit;
 - iv. shpalljen e zonave të reja për zhvillim në përputhje me parashikimet e këtij akti.
- c) kushtet, kriteret, fondin financiar dhe rregullat për përdorimin e tij, organet përgjegjëse dhe procedurat për përballimin e pasojave të veçanta të fatkeqësisë natyrore;
- ç) shpenzimet operative dhe koordinuese për mirëfunksionimin e fondit të rindërtimit;
- d) çdo vendim në lidhje me çështje të tjera në funksion të zbatimit të këtij akti normativ.
- Komisioni Shtetëror i Rindërtimit, referuar në nenin 14, përbëhet nga 9 ministra, aty merren vendime të cilat i propozohen Këshillit të Ministrave për të detajuar procesin qoftë financiar, qoftë administrativ apo ndërtues, rindërtues në terren.
 - Ministria e Rindërtimit në cilësinë e anëtarit të Këshillit të Ministrave, ndjek dhe bashkërendon veprimtarinë e ministrive dhe të institucioneve të tjera, publike e shtetërore, për hartimin dhe miratimin e programeve të procesit të rindërtimit, shpërndarjen e fondeve për realizimin e këtyre programeve, evidentimin e burimeve të brendshme, materiale dhe njerëzore, drejtimin operacional të strukturave dhe të njësive të veçanta, ndjekjen e zbatimit të përgjegjësive dhe të detyrave të ngarkuara për to etj.
 - Instituti i Ndërtimit ka objekt kryesor kryerjen e veprimtarisë kërkimore, shkencore, zhvillimore, projektuese në fushën e ndërtimit, si dhe në procesin e rindërtimit detyra kryesore e tij ishte ekspertiza e thelluar dhe oponenca për vlerësimet e konformitetit dhe kontrollet për produktet e ndërtimit që lidhen me sigurinë e jetës.
 - Njësitë e qeverisjes vendore në këtë fatkeqësi natyrore kanë detyrimet të përcaktuara në Aktin Normativ nr. 9 datë 06.12.2019. Këshilli bashkiak në procesin e rindërtimit duhet të: Administrojë fondet që transferohen nga Këshilli i Ministrave, të miratojë planet e detyruara dhe të detajuara vendore, lejet e zhvillimit e të ndërtimit, të krijojë, administrojë dhe përditësojë bazën e të dhënave për individët dhe familjet që kanë humbur familjarë dhe/ose kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe të plotësojë nevojat e tyre nga programet e procesit të rindërtimit. Bashkia përmes përfaqësuesve në Njësitë Administrative kryen inspektimin viziv të dëmeve, ngre dhe monitoron grupet e punës për vlerësimin e të gjithë dëmeve, nga Niveli DS1 deri në DS5.

Në nenin 1 dhe 2 të VKM Nr. 26, datë 15.1.2020 *“Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara”*, parashikohet ndër të tjera se: *“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse shtetërore do të kryejnë aktekspertizë të thelluar për të gjitha objektet për të cilat kërkohet një rivlerësim më i thelluar, mbështetur në aktkonstatimet ose aktvlerësimet paraprake të Institutit të Ndërtimit apo të grupeve përkatëse të inspektimit. 2. Aktekspertiza e thelluar i vihet në dispozicion Institutit të Ndërtimit për kryerjen e oponencës. Instituti i Ndërtimit jep opinionin e tij, i cili mbizotëron mbi aktekspertizën e thelluar dhe zbatohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse.”*

Mështetur në provat e administruara, si rezultat i fatkeqësisë natyrore, tërmeti që goditi Shqipërinë në datë 26 Nëntor 2019, dëmtoi edhe ndërtesën në të cilën banon ankuesi, pallatin 1047 (Arvi). Referuar legjislacionit dhe akteve të sipërcituara, Bashkia Durrës përmes përfaqësuesve të saj në Njësitë Administrative ka kryer inspektimin viziv të dëmeve në këtë objekt duke vlerësuar fillimisht dëmtim të tij të shkallës së II, pra nivel dëmi DS2.

Neni 34, i Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019, “Aktekspertiza e thelluar e ndërtesave të dëmtuara”, parashikon ndër të tjera se: “

1. Për ndërtesat që kanë pësuar dëme dhe që janë shpallur të pabanueshme nga aktkonstatimet apo aktvlerësimet paraprake të Institutit të Ndërtimit apo grupet përkatëse të inspektimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse shtetërore me qëllim garantimin e jetës dhe shëndetit, mund të kryejnë aktekspertizë të thelluar sipas procedurës të përcaktuar në këtë nen. Aktekspertiza e thelluar kryhet dhe për të gjitha ato objekte kur sipas aktkonstatimeve ose aktvlerësimeve paraprake të Institutit të Ndërtimit apo grupeve përkatëse të inspektimit, kërkohet një rivlerësim më i thelluar.
2. Aktekspertiza e thelluar përmban, përveç të tjerave, përshkrimin e hollësishëm të gjendjes së objektit, dëmet e pësuar, gjendjen strukturore, masat për riparimet dhe ndërhyrjet që duhen kryer për të garantuar sigurinë e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, si dhe vlerën financiare për këto ndërhyrje. Ekspertiza jep një konkluzion të qartë mbi gjendjen strukturore, nëse objekti mund të riparohet apo struktura e tij është dëmtuar në atë masë që dikton prishjen e detyruar të objektit.
3. Aktekspertiza e thelluar i nënshtrohet opionencës teknike nga Instituti i Ndërtimit dhe opinionin e tij mbizotëron mbi aktekspertizën e thelluar dhe zbatohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse.
4. Nëse sipas studimit të thelluar, të mbështetur dhe nga opionenca e Institutit të Ndërtimit, ndërhyrjet për riparimin e strukturës kushtojnë më shumë se 70% e kostos së rindërtimit nga e para të ndërtesës, njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti përgjegjës vendos shembjen e detyruar të objektit, që kryhet sipas procedurave të parashikuara në nenin 35 të këtij akti.
5. Për vlerësimin e menjëhershëm dhe në çdo rast deri në përfundim të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, të dëmeve të ndërtesave publike ose private, njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti përgjegjës ndjek procedurën e prokurimit me negociim pa shpallje për mbulimin e nevojës emergjente, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik. Procedura e prokurimit publik në këtë rast zhvillohet në formë shkresore.
6. Lejet e ndërtimit, lejet përkatëse për rikonstrukcionin apo lejet e shembjes së ndërtesave, sipas parashikimeve të këtij neni, miratohen me procedura të përshpejtuara sipas parashikimeve me vendim të Këshillit të Ministrave, dhe përjashtohen nga taksa për ndikimin në infrastrukturë, si dhe tarifat e aplikimit të zbatueshme për lejet e ndërtimit.
7. Shpenzimet për aktekspertizën e thelluar, riparimin apo shembjen e objekteve të dëmtuara sipas parashikimeve të këtij neni dhe nenit 35, të këtij akti, mbulohen nga buxheti i njësisë

së vetëqeverisjes vendore apo autoritetit përgjegjës ose në rast pamundësie nga fondi i rindërtimit kur miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave...”.

Sipas informacionit të dhënë, ankuesi dhe banorët e tjerë të pallatit duke mos qenë dakord me vlerësimin e bërë nga strukturat e Bashkisë Durrës, kanë kundërshtuar aktin e vlerësimit të bërë dhe kanë kërkuar ekspertizë të thelluar nga ana e Institutit të Ndërtimit. Sakaq, referuar Akt Ekspertizës mbi Performancën Strukturore të Ndërtesës Nr. 16 (1047), në Rrugën e “Epidakëve”, të realizuar nga Instituti i Ndërtimit gjatë vitit 2020, u vlerësua se godina nuk plotëson kushtet sizmike dhe duhet rirforcuar sa më shpejt. Pra, godina pas ekspertimit u vlerësua me nivel dëmi DS4.

Sakaq, sipas informacionit të dhënë gjatë seancës dëgjimore, pas akt ekspertimit të Institutit të Ndërtimit, Bashkia Durrës ka shpallur procedurën e prokurimit për kontraktimin e një studio projektuese për hartimin e projektit të rirforcimit dhe preventivin e tij. Në këtë kuadër, referuar shkresës nr. 1723/1 prot., datë 17.02.2023 dhe parashtimeve të bëra gjatë seancës dëgjimore të Bashkisë Durrës, më datë 18.01.2021, është lidhur kontrata nr. 661, me studion projektuese “Arkonstudio”, e cila ka hartuar projektin dhe pretendimin përkatës për ndërtesën Nr. 16 (1047). Pasi është marrë edhe oponenta teknike e Institutit të Ndërtimit, Bashkia Durrës me shkresën Nr. 2319 prot., datë 10.3.2022, i është drejtuar Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, duke kërkuar financimin e punimeve për rirforcimin e pallatit Nr. 16 (1047), ku banon ankuesi, si dhe 7 pallateve të tjerë me nivel dëmi DS4. Mbështetur në kërkesën e Bashkisë Durrës, Komisioni i Shtetit për Rindërtimin, në pikat 20 dhe 21 të Vendimit të tij Nr. 101, datë 13.04.2022, i ka propozuar Këshillit të Ministrave përdorimin e Fondit të Rindërtimit nga Bashkia Durrës për kryerjen e punimeve për rirforcimin e 8 (tetë) njësive të banimit ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore, me shkallë dëmtueshmërie DS4.

Gjithashtu, pas kalimit të përgjegjësisë për rindërtimin nga Ministria e Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën Nr. 9462 prot., datë 24.11.2022, Bashkia Durrës iu drejtua kësaj të fundit duke kërkuar financimin e punimeve për rirforcimin e pallatit Nr. 16 (1047), ku banon ankuesi, si dhe 7 pallateve të tjerë me nivel dëmi DS4.

Në vijim, nga informacioni i marrë, nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është hartuar projekt vendimi i Këshillit të Ministrave për financimin e punimeve të objekteve me nivel dëmi DS4 në Bashkinë e Durrësit dhe i është dërguar për mendim Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë. Sakaq nuk rezulton që nga ana e Këshillit të Ministrave të jetë miratuar vendimi për përdorimin e Fondit të Rindërtimit nga Bashkia Durrës për kryerjen e punimeve për rirforcimin e 8 (tetë) njësive të banimit ndërtesa (pallat), të cilat janë klasifikuar si objekte me dëmtime të mëdha strukturore ose dëmtime shumë të rënda jostrukturore, me shkallë dëmtueshmërie DS4.

Akti Normativ Nr. 8, datë 7.12.2019 “Për përdorimin e procedurës së përshpejtuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019, parashikon ndër të tjera se:

Neni 1

Familjeve, të cilave u është dëmtuar banesa si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019, dhe janë evakuuar nga banesat e tyre për shkak se u rrezikohet jeta dhe shëndeti, u subvencionohet në masë të plotë pagesa e qirasë së banesës, në vlerën mesatare të tregut të lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe/ose njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 2

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, ngarkohen:

- të hartojnë listat e familjeve, banesat e të cilave janë shembur ose janë klasifikuar si të pabanueshme me akt konstatimi nga Instituti i Ndërtimit;
- të vlerësojnë nivelin mesatar të qirasë për struktura të ndryshme apartamentesh, brenda 5 ditëve pune nga hyrja në fuqi e këtij akti normativ;
- të miratojnë, në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, listën e familjeve përfituese;
- të dërgojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë kërkesën për mbështetje buxhetore për financimin ose bashkëfinancimin e subvencionit, në mënyrë elektronike dhe shkresore, së bashku me informacionin për numrin e familjeve të ngelura të pastreha, sipas klasifikimit të bërë nga Instituti i Ndërtimit.

Neni 3

1. Për përfitimin e subvencionit të pagesës së qirasë, sipas këtij akti normativ, familjet aplikojnë pranë njësisë së vetëqeverisjes ku kanë vendbanimin e tyre, duke dorëzuar dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- a) Formularin e aplikimit, sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi;
- b) Aktkonstatimin e Institutit të Ndërtimit;
- c) Certifikatën familjare;
- ç) Numrin e llogarisë bankare ku do të derdhet pagesa e qirasë.

2. Struktura përgjegjëse, e ngarkuar nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me strukturat e tjera, përgatitë menjëherë projektvendimin për miratim nga këshilli bashkiak.

Neni 4

Nëse një familje, e cila është e regjistruar në një njësi të vetëqeverisjes vendore, për arsye personale, kërkon të gjejë banesë për strehim në një njësi tjetër të vetëqeverisjes vendore, atëherë përfiton subvencionimin e qirasë në vlerë të barabartë me atë të njësisë ku ndodhet banesa e dëmtuar. Ndërsa, kur gjetja e një banese për strehim në njësinë ku ndodhet banesa e dëmtuar është e pamundur, konfirmuar nga organi i kësaj njësie, atëherë përfiton subvencionimin e qirasë në vlerë të barabartë me atë të njësisë ku është strehuar.”

Neni 26, i Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019, “Pagesa e qirasë”, parashikon ndër të tjera se: “

1. Familjet e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, të mbetura të pastreha pasi banesat ose shtëpitë e banimit individuale të tyre janë klasifikuar si objekt i dëmtuar ose i pabanueshëm, përfitojnë një pagesë qiraje në vlerën mesatare të tregut të lirë, për një vit, që miratohet me vendim të organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore.

2. Për përfitimin e pagesës së qirasë, subjektet përfituese aplikojnë pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore ku kanë vendbanimin, duke dorëzuar dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) Formularin e aplikimit sipas formati të miratuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore;

b) Aktkonstatimin e Institutit të Ndërtimit;

c) Certifikatën familjare;

ç) Numrin e llogarisë në një bankë të nivelit të dytë.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë procedurat e përsheptuara për shqyrtimin e aplikimeve dhe miratimin përkatës të subjekteve përfituese dhe të nivelit të qirasë me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

4. Pagesa e qirasë, pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, mund të miratohet deri në përfitimin e banesës së re nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose deri në përfundimin e ndërtimit apo të rikonstruksionit të banesës, në zbatim të programeve të procesit të rindërtimit të parashikuara në këtë ligj, nëse përfituesi plotëson kriteret dhe dokumentacionin përkatës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për strehimin social.

5. Shpenzimet e qirasë përballohen nga fondi i rindërtimit, si dhe nga të ardhurat e njësive të vetëqeverisjes vendore.

6. Njësia e vetëqeverisjes vendore mund të miratojë qiranë e banesës, sipas parashikimeve të këtij neni, dhe për familje që nuk janë banorë të territorit të vet por që rezultojnë subjekte përfituese në territorin e një njësie tjetër të vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, bazuar mbi një kërkesë të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, në kushtet e mungesës së mundësive për strehim në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi”.

Referuar akteve të sipërcituara, Këshilli i Ministrave ka miratuar paketën e plotë ligjore për t’i paraprirë situatës së vonesave të mundshme gjatë procedurave administrative të rindërtimit, si në rastin konkret të miratimit të fondit për rirforcimin e ndërtesës ku banon subjekti ankues. Sakaq, përmes miratimit të akteve normative të sipërcituara, Këshilli i Ministrave, për të mos vënë në rrezik jetën e banorëve të cilët jetojnë në ndërtesa të dëmtuara, i ka dhënë ankuesit dhe banorëve të tjerë, mundësinë për të gjetur një banesë tjetër në tregun e lirë, për të cilën organet e njësive të vetëqeverisjes vendore deri në përfundimin e ndërtimit apo të rikonstruksionit të banesës, ti rimburojnë qiranë në vlerën mesatare të tregut të lirë. Në këtë kuptim, duke marrë në konsideratë situatën e jashtëzakonshme të krijuar si rezultat i fatkeqësisë natyrore, tërmetit që goditi Shqipërinë në datën 26 Nëntor 2019, Komisioneri gjykon se pavarësisht situatës së krijuar nga Këshilli i Ministrave apo Ministritë e tjera, si rezultat i vonesës së miratimit të fondit për rirforcimin e ndërtesës ku banon ankuesi, qeveria i ka ofruar alternativa subjektit ankues dhe personave të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të, për tu strehuar në një banesë me qira, e cila do të mbulohet nga

strukturat përgjegjëse të njërive të vetëqeverisjes vendore deri në momentin e rikonstruksionit të banesave.

Nga analiza e provave të administruara dhe informacionit të parashtruar nga ana e Bashkisë Durrës gjatë seancës dëgjimore, rezulton se në qytetin e Durrësit janë 8 (tetë) njësi banimi ndërtesa (pallat), të cilat ndodhen në të njëjtat kushte. Pra, veç ndërtesës (pallatit) Nr. 16 (1047), ku banon ankuesi, janë dhe 7 ndërtesa (pallate) të tjera me nivel dëmi DS4, për të cilat nuk është miratuar fondi i rifuortimit nga ana e Këshillit të Ministrave. Madje, një prej 7 ndërtesave (pallateve) është në afërsi banesës së subjektit ankues.

Lidhur me mospërfitimin e pagesës së qirasë nga ana e Bashkisë Durrës, ankuesi nuk vuri në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi asnjë fakt me anë të të cilit të provonte se ka aplikuar pranë Bashkisë Durrës për përfitimin e pagesës së qirasë. Ky pretendim u parashtrua nga ankuesi vetëm gjatë seancës dëgjimore duke cituar se në rrugë informale ka kërkuar të trajtohet me pagesën e qirasë dhe nuk ka depozituar asnjë provë apo fakt lidhur me të.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”.*

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.*

Neni 20/1 i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht:

“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato:

a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji;

b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo

shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi të pabarabartë dhe të pafavorshëm nga ana e subjekteve ndaj të cilëve ka paraqitur ankesën, pasi në kushtet e tij ndodhen edhe subjekte të tjerë të cilët janë trajtuar në të njëjtën mënyrë.

Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri, arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkisë Durrës, kundrejt ankuesit, për shkaqet e pretenduara prej tij.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 32 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, K. H., për shkaqet e pretenduara, nga ana e Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkisë Durrës, në fushën e të mirave dhe shërbimeve.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Vendbanimi dhe gjendja ekonomike)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)